

VENDIM
Nr. 577, datë 13.10.2017

**PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË NJË ANËTARI TË KËSHILLIT TË
STATISTIKAVE DHE ZËVENDËSIMIN E TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 4, shkronja “a”, e 5, të nenit 10, të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004, “Për statistikat zyrtare”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 15, të vendimit nr. 999, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e përfaqësimit, përzgjedhjes, të emërimit e të shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkarkimin nga detyra e anëtarit të Këshillit të Statistikave të z. Endrit Lami, përfaqësues i Ministrisë së Financave, sipas shkronjës “a”, të pikës 4, të nenit 10, të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004, të ndryshuar.

2. Zëvendësimin e anëtarit të Këshillit të Statistikave, të përmendur në pikën 1, me z. Nikolla Lera, përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për pjesën e mbetur të mandatit, sipas pikës 5, të nenit 10, të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama